

Ragmi Mustafa është i lindur më 18 maj 1962 në fshatin Zhunicë, komuna e Preshevës. I martuar, baba i katër fëmijëve.

Më 17 maj të vitit 2003 zgjedhet kryetarë i Partisë Demokratike Shqipëtare (PDSH) në Preshevë në mandat prej katër vitesh. Më 13 maj 2007 përsëri zgjedhet kryetarë i PDSH me seli në Preshevë në mandat prej katër vitesh.

Në vitin 1987 diplomon në fakultetin elektroteknik-drejtimi elektronikës në Univerzitetin e Prishtinës. Në periudhën 1987-2004 punon si profesor i informatikës në gjimnazin „Skënderbeu” në Preshevë.

Në nëntorë të vitit 2004 zgjedhet kryetarë i Kuvendit Komunal të Preshevës. Në janar të vitit 2005 zgjedhet kryetarë i komunës së Preshevës, kurse në qershorë të vitit 2006 në zgjedhjet lokale përsëri zgjedhet kryetarë i komunës së Preshevës. Më 11 maj të vitit 2008 zgjedhet kryetarë i Kuvendit Komunal të Preshevës dhe këtë funksion mbajti deri më 20 maj të vitit 2009 kur përsëri zgjedhet kryetarë i komunës së Preshevës.

Deri më tani ka qenë në udhëtim studijoz në Republikën Çeke. Kontakton me ministritë në nivelin ministrorë në Qeverinë e Republikës së Serbisë, Trupin Koordinues së Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë si dhe gati me të gjitha ambasadorët e shteteve që janë të akredituara në Beograd. Bashkëpunon me përfaqësuesit e pushteteve lokale përmes “East West Institute” në mikroregjion të bashkëpunimit ndërkufitarë Preshevë, Gjilan, Kumanovë dhe Trgovishtë. Bashkëpunon me të gjithë donatorët ndërkombëtarë siq janë: UNDP, USAID, CHF, HELP etj në projektet investive infrastrukture si dhe zhvillimin ekonomik të komunës së Preshevës.